



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i  
Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 432/101 B

Dt. 14.11.2011

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nenit 9 paragrafit 1 dhe 10 paragrafit 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare nr. 14,9 shtator 2011), nxjerr:

#### V E N D I M

1. Themelohet Universiteti publik "Haxhi Zeka" në Pejë si institucion arsimor dhe i kërkimit e shkencës, i cili do jep diploma e grada shkencore deri në nivelin e doktoratës.
2. Obligohen organet e MASHT-it, që të bëjnë të gjitha përgatitjet e nevojshme për themelimin dhe funksionalizimin e Universitetit publik "Haxhi Zeka" në Pejë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

#### A r s y e t i m

Duke pasur parasysh dispozitat e lartshënuara dhe nevojën për përfshirjen e numrit sa më të madh të studentëve në shkollimin e lartë me synim:

1. Përparimin në fushën e njohurive akademike, në Kosovë, në rajon dhe më gjerë;
2. Zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës; zhvillimin e shkathtësive profesionale dhe të kompetencave të larta; dhe
3. Nxitjen e qytetarisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta në mësimdhënie dhe mësimnxënie, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimit.

#### Vendimi i dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit,
2. Sekretarit të përgjithshëm,
3. Departamentit të arsimit të lartë;
4. Departamentit ligjor;
5. Arkivit.

Prof. dr. Ramë Buja, ministër



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i  
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 435/01 B

Datë. 14.11.2011

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 18 paragrafi 2 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14,9 Shtator 2011), në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nxjerr :

#### V E N D I M

1. Emërohen anëtarët e Këshillit Drejtues të përkohshëm të Universitetit publik "Haxhi Zeka" të Pejës, me këtë përbërje:
  - 1.1. Armand Krasniqi,
  - 1.2. Ali Berisha,
  - 1.3. Ilhami Gashi,
  - 1.4. Xhelal Radoniqi,
  - 1.5. Naser Mrasori,
  - 1.6. Drita Kadriu,
  - 1.7. Usnija Bibilica,
  - 1.8. Haxhi Kastrati,
  - 1.9. Linda Grapci.


2. Rektori themelues dhe Drejtori i Departamentit të arsimit të lartë, marrin pjesë në takimet e Këshillit Drejtues të përkohshëm qeverisës, por pa të drejtë vote.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### **A r s y e t i m**

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë si dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore që burojnë nga këto dispozita ,u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Vendimi u dërgohet:**

- 1 Anëtarëve të Bordit të përkohshëm të UP-së;
- 2 Kabinetit të Ministrit;
- 3 Zyrës së Sekretarit;
- 4 Departamentit të arsimit të lartë;
- 5 Departamentit ligjor;
- 6 Divizionit të personelit;
- 7 Arkivit.

  
**Prof. dr. Ramë Buja, ministër**